



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
27.03.2019, duke filluar në orën 15:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rrahmani, Fadil Gashi, Genc Sherifi dhe Egzon Azemi.

**Mungoi:** Blerand Stavileci.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Qëndrim Arifi, përfaqësues nga INPO-ja, Faton Ajeti, përfaqësues nga OSCE-ja dhe Fahri Krasniqi, përfaqësues nga Hendikos.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta, kryesues, me këtë**

### **REND TË DITËS:**

#### **1. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2018 në vitin 2019.**

Kryesuesi tha se rendin e ditës e keni marrë, kjo është një seancë e jashtëzakonshme. Duke u nisur prej një sugjerimi dhe obligimi ligjor, e kemi thirrur Komitetin, megjithëse kohë e shkurtër, por besoj se kanë qenë pozicionet që keni pasur kohë me shqyrtuar. Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**Agim Gashi** pyeti lidhur me mbajtjen e seancës së Kuvendit.

**Kryesuesi** u përgjigj se është konsultuar me të gjithë, kjo mbledhje e jashtëzakonshme në Kuvend mbahet të premtën, sepse në KPF-në e kaluar nuk kemi pasur kohë me trajtuar dhe është material që ka të bëjë me financat, prandaj është dashur me pasur dakordinin e të gjithëve për me dërguar, me futur si pikë të rendit të ditës.

**Vala Peshku** pyeti se a ka pasur kundër, që mos me u futur kjo pikë në mbledhjen e rregullt për të enjten.

**Kryesuesi** u përgjigj, duke thënë po, ka pasur kundër.

**Fadil Gashi** tha se pse nuk e keni futur në rend dite, drejtori ka thënë në mbledhjen e kaluar se vetë kryetari e futë në rendin e ditës.

**Kryesuesi** tha se kjo ka karakter financiar, duhet me u trajtuar edhe në KPF.

**Agim Gashi** theksoi se një mbledhje e kemi mungesë, në janar, e me këtë e mbulojmë janarin me pagesë.

**Fadil Gashi** propozoi që të futet në rend dite për mbledhjen e së enjtes, për shkak se nuk ka shumë pika për diskutim.

**Agim Gashi** u shpreh se keni bërë shumë mirë që e keni thirrur këtë takim, se ne e kemi pasur në plan me e ngritur në mbledhjen e rregullt këtë çështje, për arsye të situatës urgjente që ndërlihet me vendimin e marrë për përkrahjen e Pallatit të Rinisë dhe ish-Fabrikën e tjegullave, kjo është një procedurë ligjore që duhet të zhvillohet, për të dhënë mundësi për zbatimin e vendimit të muajit janar. Ne jemi vonuar, e që nuk është dashur të vonohemi, sepse punëtorët e Pallatit të Rinisë tash e 3 - 4 muaj nuk kanë marrë paga.

Sa i përket buxhetit, unë kam propozime konkrete, por ato do t'i jap në mbledhje të Kuvendit, mirëpo shqetësimi im është se në listën e propozuar nga drejtori i Infrastrukturës, kemi këtu 50% të rrugëve në fshatin Busi që nuk janë përfshirë, dhe është projekt esencial, për shkak se banorët jetojnë atje, janë afër 100 familje dhe 50% i kanë përfshirë dhe 50% nuk i kanë përfshirë, e kjo nuk është në rregull, sepse kemi fshatra që nuk jeton askush dhe janë hyrë në prioritet, si p.sh. rruga Mat - Butovc, ku vetëm për vikend dalin njerëzit se nuk jeton askush atje lart, kemi edhe të tjera të tilla.

**Fadil Gashi** pyeti se ku në Busi, sepse kam informata se Busia është përfshirë.

**Agim Gashi** dha sqarime, duke thënë se 50% të rrugëve brenda lagjes Busi janë përfshirë në projektin që është tenderuar dhe rreth 800 m gjatësi kanë mbetur pa u përfshirë, lagja Kullaj, që është mbi Busi, dhe ka banorë që jetojnë, kanë biznese, ferma etj. dhe jetojnë në kushte të vështira, i kemi vizituar me kryetarin, drejtorin, me disa këshilltarë dhe është premtuar se këtë vit do të hyjë një rrugë që e ka bazën stabile, është punuar më herët baza e asaj rruge, por nuk është përfshirë. Shko në drejtori dhe i sheh se nuk janë përfshirë.

**Vala Peshku** pyeti se a janë këto 800m që nuk janë përfshirë në tender dhe ku gjendet lagja "Kullaj", sa km i ka.

**Agim Gashi** u përgjigj, se lagja "Kullaj" është mbi Busi, është pjesë e atij lokaliteti, ka rreth 1.5 km eventualisht 2 km prej Vidimes, por baza e rrugës është e ndërtuar.

**Eman Rrahmani** theksoi se në mbledhjen e kaluar zotëri Agim Gashi ka kërkuar me e futur si pikë të rregullt të rendit të ditës dhe ka mundur të hyjë për të entjen që kemi mbledhje. Këtë punë kemi mundur me e kryer në mbledhjen e kaluar të KPF-së dhe e kishim përfunduar, se ky

proces duhet sa më shpejt me përfunduar dhe kemi pasur mundësi me pasur më herët materialin dhe me analizuar, me dhënë propozime, kështu për 2-3 ditë nuk kemi mundësi me dhënë kontributin që duhet dhënë. Kjo ka mundur të kryhet në mbledhjen e kaluar.

**Sami Boroci** shprehu mendimin se për të nuk është problem mënyra e thirrjes së mbledhjes, nuk është që ka ndonjë volum të madh të materialit që të na pamundësojë me analizuar, kështu që për mua është në rregull nëse vendosni me shkuar me seancë të jashtëzakonshme ose vendosni me e futur në seancën e së nesërme, nuk ka asnjë problem. Në aspektin personal, i vetmi problem ndoshta është vlera e mjeteve që duhet bartur. Unë jam pak kundër logjikës që me i bartur 23 milionë € çdo vit, e besoj se Komuna duhet me siguruar se buxheti realizohet në përqindje më të madhe e jo me i bartur 23 milionë €, por në fakt janë në rregull, normalisht se kemi me votuar për.

Sa i përket projekteve konkrete, i kam analizuar disa këtu, e di se janë planifikime të drejtorive, mirëpo i kam disa pyetje, të cilat do t'i parashtrij në Kuvend, si p.sh. ndërtimi i stadiumit të futbollit në Hajvali, faza I, faza II, e di se edhe në të kaluarën këtu janë ndarë disa mjete, edhe në mandatin e kaluar kemi votuar një bartje me një vlerë të madhe, e ky proces është ndalur, andaj do të kërkoj sqarime prej ekzekutivit në këtë rast për këtë projekt, ndoshta edhe kemi me pasur propozime për ndonjë lëvizje të caktuar.

**Egzon Azemi** shprehu mendimin se është mirë që të gjitha grupet me i pasur propozimet për disa ndryshime të bartjes së mjeteve, e pastaj në Kuvend dakordohemi, meqenëse është edhe kompetencë e asamblesë të votojë bartjen dhe destinimin e këtyre mjeteve ku është më prioritet të destinohen. Kam një pyetje, se është e pakuptueshme se si vlera e një salle të edukatës fizike të shkollës "Shtefën Gjeqovi" është 238,564.24 €, ndërsa te numri 60, te destinimi, ndërtimi i sallës së edukatës fizike të shkollës, ku emri i shkollës nuk ceket, është shuma 100 mijë €, e që bie 100% më lirë, andaj kisha kërkuar sqarim për këtë.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se bartja është, siç e keni parë, 23,342,809.24€. Arsyeja kryesore, që ke pyetja prej kolegëve se pse është vonuar dhe nuk është ardhur më herët, se dje dhe sot kam pasur takim me drejtorin e Buxhetit në kuadër të Ministrisë së Financave, se nuk kam dashur me dërguar në Kuvend diçka që nuk ka qenë e qartë, destinacioni dhe kategoria të cilën e kanë kërkuar. Sipas Ministrisë së Financave, këto nuk munden me shkuar më si projekte kapitale, por duhet me shkuar si subvencione dhe transfere, këtë nuk e kisha të qartë.

**Agim Gashi** kërkoi nga drejtoresha shpjegime, se çka përfshin zona e transferit dhe a është fjala vetëm për projektet paraprahe.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha përgjigje, duke thënë se se transferi është një shumë që jepet dhe nuk ka kthim, një herë bëhet një transfer.

**Eman Rrahmani** theksoi se me rastin që e keni bërë bartjen e mjeteve për Pallatin e Rinisë dhe ish-Fabrikën e tjegullave është shkelur ligji, për shkak se nuk ka të drejtë të bëhet bartja

drejtpërdrejt, pa e bartur njëherë si subvencion, dhe këtë ja ka kthyer Ministria e Financave si jo të ligjshme.

**Kryesuesi** tha se nuk është kthyer si jo e ligjshme, por ka thënë nuk mund të zbatohet ky vendim pa u ndjekur procedurat tjera.

**Eman Rrahmani** u shpreh se për mendimin e MAPL-së ju na keni thënë se është e ligjshme dhe është në rregull gjithçka.

**Kryesuesi** theksoi se atje nuk ka thënë se është e paligjshme, por nuk mund të ekzekutohet, sepse aty nuk janë ndjekur procedurat e nevojshme.

**Agim Gashi** tha se ne e kemi shtruar pyetjen në Kuvend, kur kryetari e ka arsyetuar propozimin, dhe i kemi thënë se thesari është mbyllur, e ne dy ditë mbasi është mbyllur e kemi sjellë në Kuvend. Na është përgjigjur se kemi marrë premtime nga Ministria se për neve nuk do të mbyllet, kështu ka qenë, dhe kur i ka shkuar Vendimi Ministrisë, ka thënë se i ka kaluar afati dhe duhet edhe një herë me u bërë bartja pastaj me ardhur propozimi.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se çështje tjetër që është kërkuar prej drejtorit të buxhetit janë nënkodet. Që mos me u kthyer edhe një herë për nënkodet, i kemi shënuar te arsyetimi, e kemi përmirësuar edhe arsyetimin.

**Agim Gashi** tha se ju i keni propozuar nënkodet, por ne ende nuk i kemi votuar nënkodet, andaj ne po i kërkojmë nënkodet në bazë të propozimeve tona, me i respektuar aty se ne po i përfaqësojmë disa interesa të qytetarëve, e më mirë është rrugën për Butovc mos me e shtruar se askush nuk jeton atje, e me i shtruar rrugët ku njerëzit jetojnë 24 orë dhe 12 muaj të vitit dhe me prioritet, është mundësia ju me i përmirësuar.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se te subvencionet dhe transferet janë 187 mijë të Administratës, 250 mijë janë të Sektorit të bujqësisë, të cilat janë mbetur të Komunës dhe këto dyja janë të parapara dhe votuar një herë. Diçka që është e re për mua dhe drejtorin, që e kemi paraqitur në bazë të raportit të auditorëve, kemi shumë llogari të hartueshme, të cilat janë në rritje e sipër, e ne kemi bërë një plan të veprimit që me shkuar deri te mbyllja e tyre. Obligimet më të mëdha janë ardhur ndaj komunalive dhe ato vetëm në një digaster, në Drejtorinë e Arsimit, e cila e ka buxhetin shumë të vogël, janë borxhe që janë mbledhur, janë llogari që ne duhet me i paguar komunalive dhe kemi marrë disa hapa për to.

Sa i përket investimeve kapitale, e kemi bërë këtë raport me drejtorin, me të gjitha ato kompani që projektet veç janë lidh kontratat dhe janë paguar një këst, dy këste. Po ndalem te salla e edukatës fizike, që u përmend nga Egzoni. Për atë sallë është fituar shumë vonë tenderi dhe nuk ka situacion të pagesës, d.m.th. nuk ka filluar ende, ndërsa te shkolla tjetër kanë mbetur dy - tri punë pa u kryer dhe ato janë krejt në prokurim, i shihni sa janë fituar ato çmime, asnjë projekt nuk është hyrë më vonë, të gjitha janë projekte që janë të lidhura, d.m.th. të kontraktuara, të miratuara me buxhet dhe të cilat kanë mbetur obligim me u paguar, ose një pjesë janë paguar dhe një pjesë kanë me u paguar.

**Vala Peshku** theksoi, te salla e edukatës fizike, te 60, patjetër duhet me u cekur emërtimi i shkollës, përndryshe, me këto informacione nuk mundemi me ditur arsyen se si njëra sallë e edukatës fizike mundet me kushtuar më lirë e tjetra më shtrenjtë, se krejt varet çka ka me u punuar atje.

**Agim Gashi** bëri vërejtje për mungesën e drejtorëve, drejtoritë e të cilëve kanë lidhshmëri me bartjen e buxhetit, se KPF është orientues fillestar i buxhetit, dhe kur të vjen në Kuvend 90% duhet së paku me qenë stabil propozimi, për shkak se trajtohet në mbledhje të KPF-së, ku përfaqësohet nga të gjitha subjektet këtu, dhe mungesa e drejtorëve, kryetarit, nënkryetarit etj. tregon një mos seriozitet, prandaj ndodh mos pagesa e komunalive.

**Sami Boroci**, kur është fjala për mungesën e drejtorëve, që e përmendi edhe Agim Gashi, tha se ne e kemi trajtuar edhe një herë në KPF këtë çështje dhe kemi kërkuar nga kryesuesi me iu dërguar nga një shkresë, nëse është nevoja edhe e nënshkruajmë të gjithë anëtarët e KPF-së, dhe me iu kërkuar kur të kenë pika me qenë në Kuvend. Kryesues, ndoshta kishte qenë mirë me iu dërguar një shkresë në emër të KPF-së, me paraqitur këtë kërkesë, se unë i kam parë disa drejtorë që vinë gjithë kohën dhe është shumë mirë, se po japin informacione, mirëpo kemi edhe të tjerë që nuk vijnë asnjëherë në KPF. Çështja tjetër që u përmend nga parafolësit, për ndërtimin e rrugëve në Busi etj., unë kam me kërkuar sqarime se cilat rrugë parashihen, kemi me pasur pyetje për drejtorë, qoftë edhe për pikën 60, që ke ndërtimi i sallës së edukatës fizike, kështu që drejtorët kishte qenë mirë me qenë të pranishëm.

**Kryesuesi** tha se kemi një propozim nga Fadili, që në mbledhjen e së enjtes të futet si pikë e rendit të ditës: "Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2018 në vitin 2019".

**Osman Bllaca**, lidhur me mbledhjen e jashtëzakonshme për muajin janar, për realizimin e pagesave, tha se me ligj e kemi të obliguar realizimin e pagesave deri në 12 mbledhje brenda vitit. Ne e kemi mbajtur mbledhjen më 8 mars, që ka qenë 8 Marsi - Dita e gruas, dhe atë mbledhje mund ta kompensojmë për muajin janar.

**Kryesuesi** pyeti se a pajtoheni, pasi po e dërgoni për kompensim.

**Sami Boroci** shprehu mendimin se më parë duhet trajtuar kjo mbledhje e jashtëzakonshme dhe me u mbajtur ditë e veçantë, se me procedua për pagesë atë të 8 Marsit.

**Halim Halimi** tha se me sa po e shoh unë, jo vetëm sot, por prej fillimit edhe në KPF dhe në Kuvend, mos prania e drejtorëve flet shumë, d.m.th. nuk janë shumë të interesuar. Kryesuesi nuk mundet të marrë sanksione ndaj drejtorëve që nuk po vijnë, as ne, mirëpo ne jemi ata që drejtorëve që nuk vijnë me i arsyetuar këtu pikët e propozuara, siç është ardhur drejtoresha e Financa sot, ne mundemi mos me ua votua materialet.

**Osman Bllaca** tha se për çdo mbledhje të KPF dhe të Kuvendit, të gjithë drejtorët njoftohen edhe me shkrim, edhe me e-mail dhe hart-copy, iu shkon në mënyrë të shtypur materiali i mbledhjes. Ligjërisht, nuk e kanë obligim me ardhur drejtorët në Kuvend, ata e kanë obligim

prej praktikës së mirë me ardhur, as kryetari nuk e ka obligim me ardhur, por unë jam me qenë drejtorët në mbledhje.

**Vala Peshku** tha se po të ishte obligim ligjor që të vijnë në mbledhje, sigurisht se do të vinin.

**Kryesuesi** lidhur me propozimin e Fadilit, tha se jam për me qenë në seancën e së enjtes, ne duhet me pasur konsensus këtu, dikush mos me u pajtuar këtu ka të drejtë, se proceduralisht edhe e kemi thirrur mbledhjen.

**Vala Peshku** tha se në këtë aspekt pyeta se a ka pasur të tillë që kanë qenë kundër, se e di prej Blerandit e-maili ka ardhur, prej Fadilit ka ardhur, prej meje ka ardhur që ne jemi dakord me e futur në seancën e së enjtes.

**Kryesuesi** tha se Leonora ka shkruar përmes e-mailit dhe ka thënë jo, edhe me të LDK-së jam dëgjuar përmes telefonit dhe kanë thënë jo.

**Vala Peshku** pyeti se ku qëndron arsyeja se nuk pajtoheni që të futet kjo pikë në seancën e së enjtes.

**Agim Gashi** u shpreh se për me trajtuar këtë pikë të rendit të ditës, duhet kohë për me qenë vendimet tamam të plotëfuqishme, të drejta, të qëlluara, këshilltarët duhet me hulumtuar këtë listë që është propozuar këtu dhe me i dhënë mendimet e tyre për shumicën e gjërave, nuk janë informacionet e plota dhe nuk besoj se për 24 orë ju do të mund t'i identifikoni këto gjëra, jepet njëfarë mundësie më e madhe, kërkojnë me dalë me i shikuar projektet, me dhënë sugjerime, me përmirësuar dikund etj. Kjo ka qenë arsyeja jonë.

**Genc Sherifi** u shpreh i pajtimit me kolegët që kërkuar me qenë prezentë drejtorët në mbledhje, e ne si pjesë e kualicionit të subjekteve tona me ju bërë presion, që së paku drejtorët duhet me qenë prezentë dhe me dhënë informacione sikurse në seancë, ashtu edhe në KPF edhe për çështjen e seancës. Mendoj se është mirë me u mbajtur një seancë e veçantë, sepse ka projekte dhe mund ta marrim si projekt dhe ide më të mirë edhe prej drejtorëve tanë, se e gjetëm një gabim, ndoshta me shikuar pak më në detale mundemi me gjet edhe gabime të tjera, që kanë mundur me u përvjedhur edhe drejtorive të caktuara.

**Kryesuesi** tha se nuk kemi pajtim për të enjten, andaj shkojmë për të premtën, e kemi thirrur mbledhjen, procedurat janë përfillur.

**Eman Rrahmani** theksoi se materiali duhet analizuar, është kohë e pamundshme me u analizuar deri të premtën dhe po kërkojmë që kjo mbledhje me u shtyrë për javën e ardhshme, kur do të ishim të gjithë të përgatitur. Kjo mënyrë mund të bëhet edhe ndryshe, me u pajtuar ne që mos me bërë kuorumin në seancë.

**Mbledhja përfundoi në orën 15:45.**

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta**

Faqe 6 nga 6

